# Индикативна листа на инвестициски проекти на ИРР

| Projektet e identifikuara të arsyeshme. | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| TRANSPORTI | | | | | | | | | | | |
| | Emri i projektit (përfshirja e sektorit) TRANSPORTI | Përshkrimi i shkurtër i projektit (përfshirja e lokacionit) | Faza e projektit* (e arsyeshme) (detajet) | Koha e vlerësuar e nevojshme e arsyeshmërisë (në muaj) | Aktivitetet e nevojshme për të arritur arsyeshmërinë | Kohëzgjatja e projektit (përgatitja + zbatimi) | Shpenzimet totale të investimeve | Granti/Burimi | Huaja/Burimi | Bashkëfinancimi nacional | Vlerësimi i rëndësisë strategjike |
| 1. | Zëvendësimi i gardheve mbrojtëse sipas standardeve evropiane (EN), në segmentet rrugore prioritare të identifikuara përgjatë Korridorit Rrugor 10 | Qëllimi i operacionit është zëvendësimi i gardheve mbrojtëse sipas standardeve evropiane (EN), në segmentet rrugore prioritare të identifikuara përgjatë Korridorit 10 (faza 1 dhe faza 2). | 2 | 12 | Dokumentacioni i tenderit, sipas SSPT-së | Vitet 2024-2026 | 30.000.000 euro (buxheti indikativ për të dyja fazat) | TBC (për konfirmim) | SSPT | TBC (për konfirmim) | 90,7 |
| 2. | Rikonstruksioni dhe mbindërtimi i urave hekurudhore në Korridorin 10 | Rehabilitimi ose rikonstruksioni i urave kritike të vendosura në Korridorin hekurudhor strategjik 10, me qëllim të modernizimit të infrastrukturës dhe përmirësimit të sigurisë, qëndrueshmërisë, stabilitetit dhe harmonizimit të urave hekurudhore. | 1 | 24 | (dizajni i detajuar DD, DTM (dokumentacioni teknik dhe material), DT (dokumentacioni i tenderit) | Vitet 2025-2030 | 28.750.000 euro | IPA III | | 50% | 88,9 |

# Индикативна листа на инвестициски проекти на ИРР

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 3. | Rinovimi dhe rikonstruksioni i Korridorit hekurudhor 10 në Republikën e Maqedonisë së Veriut | Rinovimi dhe/ose rikonstruksioni i Korridorit hekurudhor 10 në Maqedoninë e Veriut deri në gjendjen që mundëson funksionim të sigurt dhe efikas me shpejtësinë e planifikuar, përmirësim të standardeve të sigurisë, rritje të efikasitetit operativ dhe rritje të kapacitetit transportues të korridorit. | 1 | 36 | Studimi i Fizibilitetit (SF), vlerësimi i ndikimit mbi mjedisin jetësor, hartimi i projektit (PD), dokumentacioni i tenderit (DT) | Vitet 2024-2030 | 200.000.000 euro | Korniza e Investimeve për Ballkanin Perëndimor (KIBP) | BERZH | Të konstatohet | 77,9 |
| 4. | Ndërtimi i rrugës shtetërore A3, segmentit rrugor ekspres Manastir - vendkalimi kufitar Mexhitlia | Ndërtimi i segmentit rrugor ekspres Manastir - vendkalimi kufitar Mexhitlia, me gjatësi prej 22,0 km | 2 | 9 | Përgatitja e dizajnit të detajuar | Vitet 2020-2026 | 80.000.000 euro (indikative) | Të konstatohet | Të konstatohet | Të konstatohet | 77,0 |
| 5. | Ndërtimi i rrugës shtetërore A2, segmenti i ri rrugor ekspres Ramanli - Stracin | Ndërtimi i rrugës së re ekspres Ramanli - Stracin me gjatësi rreth 30 km (Korridori 8) | 1 | 24 | dizajni i detajuar, studimi i fizibilitetit, vlerësimi i ndikimit mbi mjedisin jetësor | Vitet 2023-2027 | 150.000.000 euro (indikative) | IPA III | Të konstatohet | Të konstatohet | 63,3 |

# Индикативна листа на инвестициски проекти на ИРР

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 6. | Ndërtimi i rrugës shtetërore A1, segmenti i ri rrugor Katllanovë - Veles (korsia e djathtë) | Ndërtimi i segmentit të ri të autostradës Katllanovë - Veles, vetëm korsinë e djathtë, me gjatësi prej 25 km në Korridorin 10 | 2 | 24 | Dizajni i detajuar vetëm për korsinë e djathtë, dokumentacion i i tenderit | Vitet 2023-2028 | 150.000.000,00 euro (indikative) | IPA III | / | Të konstatohet | 63,3 |
| 7. | Ndërtimi i segmentit hekurudhor Kërçovë - Strugë | Ndërtimi i segmentit hekurudhor të Korridorit 8, segmenti perëndimor Kërçovë - Strugë me gjatësi prej 50 km | 1 | 36 | të bëhet analiza e mangësive | Vitet 2024-2030 | 425.000.000 euro | Korniza e Investimeve për Ballkanin Perëndimor (KIBP) | Banka Evropiane e Investimeve (BEI), BERZH | Të konstatohet | 50,7 |
| 8. | Ndërtimi i segmentit hekurudhor Strugë – kufiri me Shqipërinë | Ndërtimi i segmentit hekurudhor të Korridorit 8, segmentit perëndimor, nga Struga deri në kufirin me Shqipërinë, me gjatësi prej 22 km | 1 | 56 | Të bëhet studimi paraprak i fizibilitetit | Vitet 2024-2031 | 100.000.000 euro | Korniza e Investimeve për Ballkanin Perëndimor (KIBP) | BEI BERZH | Të konstatohet | 46,2 |

# Индикативна листа на инвестициски проекти на ИРР

| Sektori digjital | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Numri rendor** | **Emri i projektit (përfshirja e sektorit)** | **Përshkrimi i shkurtër i projektit (përfshirja e lokacionit)** | **Faza e projektit* (e arsyeshme) (detajet)** | **Kohëzgjatja e projektit (përgatitja + zbatimi** | **Shpenzimet totale të investimeve (euro)** | **Granti/Burimi (euro)** | **Huaja/Burimi (euro)** | **Bashkëfinancimi nacional (euro)** | **Vlerësimi i rëndësisë strategjike** |
| 1 | Vendosja e infrastrukturës nacionale për internetin me shtrirje të gjerë | Qëllimi i projektit është vendosja e rrjetit/infrastrukturës optike nacionale të transportit që do të shërbejë si autostradë e përbashkët e komunikimit për të lidhur të gjitha institucionet shtetërore, shëndetësore, arsimore, qeveritare lokale, zonat pa rrjete komerciale (të cilat nuk janë planifikuar), si dhe lokacionet për internet pa tel publik falas (WiFi) në Maqedoni. Projekti është në përputhje me Planin Operativ Nacional Brodbend dhe në përputhje me kërkesën për ndihmën teknike për përgatitjen e studimit të fizibilitetit për ndërtimin e këtij rrjeti, të miratuar nga KIBP-ja | I miratuar: koncepti studimi paraprak i fizibilitetit studimi i fizibilitetit në vazhdim | Vitet 2024-2030 | 57.131.586 | 17.360.570 / KIBP dhe BB | 30.000.000 / BB | 10.000.000 | 100 |
| 2 | BE-ja për infrastrukturë të sigurt dhe të përbashkët qeveritare | Projekti ka për qëllim të forcojë infrastrukturën digjitale të Qeverisë duke krijuar kushte të përshtatshme për akomodimin e sistemeve qeveritare të TIK-së. Qendra e sigurt dhe e besueshme e të dhënave qeveritare është faktori vendimtar në transformimin digjital të shërbimeve të e-qeverisë. Ky projekt është pjesë e Shtyllës së Lidhshmërisë dhe Infrastrukturës Qeveritare të Strategjisë Nacionale të TIK-së (në draftin përfundimtar). | I miratuar: koncepti studimi paraprak i fizibilitetit | Vitet 2024-2030 | 31.000.000 | | | | 85 |
| 3 | Vendosja e Rrjetit të Sigurt Qeveritar | Qëllimi i projektit "Vendosja e Rrjetit të Sigurt Qeveritar" është të zhvillojë dhe zbatojë infrastrukturë rrjeti të fuqishme dhe të padepërtueshme, të përshtatur ekskluzivisht për operacionet qeveritare. Kjo iniciativë nxitet nga nevoja kritike për t'i mbrojtur informacionet e ndjeshme, për të siguruar komunikim të qetë midis trupave qeveritarë dhe për të forcuar pozitën mbrojtja kibernetike nacionale.<br><br>Si përgjigje e përshkallëzimit të kërcënimeve | I miratuar: koncepti studimi paraprak i fizibilitetit | Vitet 2024-2030 | 20 M | | | | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | kibernetike dhe dobësive të reja digjitale në zhvillim, ky projekt ka për qëllim të vendos arkitekturë rrjeti më moderne të përforcuar me protokollet më të fundit të shifrimit, mekanizmat e vërtetimit me shumë faktorë dhe sistemet e avancuara të zbulimit të ndërhyrjeve. Nëpërmjet dizajnimit dhe zbatimit të saktë të kornizës së sigurt të rrjetit, projekti ka për qëllim t'i zbusë rreziqet e spiunazhit kibernetik, shkeljeve të të dhënave dhe aktiviteteve të tjera me qëllim të keq që synojnë resurset shtetërore.<br>Ky projekt është pjesë e Strategjisë Nacionale afatgjate të TIK-së 2023 - 2030 (në fazën e shqyrtimit) | | | | | | | |
| 4 | Arkivat digjitalë | Siç përparojmë në botën digjitale dhe krijojmë origjinale digjitale, na duhen mjete për të ruajtur në mënyrë të sigurt materialet në formë digjitale. Me përparimin në botën digjitale dhe krijimin e origjinaleve digjitale, është e domosdoshme të sigurohen mjete të sigurta për ruajtjen e përhershme të materialeve në formë digjitale.<br>Ne kemi nevojë për mbështetje për Arkivat Nacionalë në rajon për t'i tejkaluar sfidat e ruajtjes digjitale, me qëllim që të sigurojmë qasje të vazhdueshme në informacionet digjitale në të ardhmen. Zhvillimi i mjeteve dhe sistemeve të ruajtjes digjitale do të sigurojë integritetin dhe disponueshmërinë e shkresave digjitale.<br><br>Rezultatet e pritshme:<br>1. Zhvillohen dhe miratohen standarde për arkivimin digjital<br>2. një sërë mjetesh, sistemesh dhe këshillash për të siguruar disponueshmërinë afatgjate (mundësisht të përhershme) | | | 18+ M | | | | |

# Индикативна листа на инвестициски проекти на ИРР

| Sektori i Kapitalit Njerëzor | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Numri rendor | Emri i projektit (përfshirja e sektorit) | Përshkrimi i shkurtër i projektit (përfshirja e lokacionit) | Faza e projektit* (e arsyeshme) (detajet) | Kohëzgjatja e projektit (përgatitja + zbatimi | Shpenzimet totale të investimeve | Granti/Burimi | Huaja/Burimi | Bashkëfinancimi nacional | Vlerësimi i rëndësisë strategjike |
| **1** | Rehabilitimi i institucioneve shëndetësore - faza II Komponenti II - Konsolidimi i Spitalit Klinik Rajonal në Shtip | Të kontribuojë në zbatimin e udhërrëfyesit për ristrukturimin e sektorit shëndetësor duke vendosur rrjetin e ri të Spitalit Klinik Rajonal modern në Shtip. | E ARSYESHME | Filloi në vitin 2011 – kohëzgjatja e parashikuar e zbatimit 2022 | 57.537.478 euro (pa TVSH) | 1.400.000 euro thirrja e 15-të për NT të KIBP-së | 26.937.458 euro | | 115 |

# Индикативна листа на инвестициски проекти на ИРР

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 | Përmirësimi i kushteve për mjekimin e grupeve vulnerabile në spitalin psikiatrik në Demir Hisar | Qëllimi i projektit të propozuar janë aktivitetet për përfundimin dhe përmirësimin e ndërtimit për nevojat e spitalit në Demir Hisar.<br>Objektet ekzistuese janë të vjetra dhe mjaft të dëmtuara, në departament janë akomoduar rreth 350 pacientë në dhoma me kushte nën standarde. Rikonstruksioni ishte praktikisht i pamundur për shkak të gjendjes së keqe dhe shtrirjes funksionale (dyert dhe dritaret e brendshme të vjetruara; instalimet elektrike të vjetruara, sistemet hidraulike dhe të kanalizimit të vjetruara, ambientet e dobëta sanitare, etj.).<br>Në ndërtesën e vjetër, e cila më parë ishte ndërtesë komunale janë akomoduar rreth 210 pacientë dhe 60-70% e numrit të përgjithshëm të pacientëve. Ajo është në gjendje shumë të keqe, propozohet të shembet dhe në të njëjtin vend të ndërtohet spitali i ri sipas standarteve evropiane. | E ARSYESHME | Të konstatohet | 3.000.000.00 EURO- | 300.000 USD Donacioni nga NAVFAC | | | 109 |
| 3 | Forcimi i qasjes ndërdisiplinore mjekësore përmes themelimit të qendrave për kujdesin paliativ | Struktura organizative aktuale dhe përgjegjësitë për kujdesin paliativ janë të fragmentuara dhe bazohen në kapacitetet ekzistuese në Shkup dhe Manastir, qëllimi i themelimit të qendrave të kujdesit paliativ është ndërtimi dhe ridedikimi i ndërtesave ekzistuese në qendra paliative me qëllim të ofrimit të shërbimeve paliative për popullsinë në përputhje me rekomandimet e praktikave më të mira nga Asociacioni Evropian për Kujdesin Paliativ. | | Të konstatohet | Të konstatohet | | | | 97 |
| 4 | Konsolidimi i infrastrukturës së ofruesve të shërbimeve shëndetësore | Rajonalizimi dhe decentralizimi i shërbimeve shëndetësore me ndërtimin e 1 Qendrës Klinike Universitare, 3 spitaleve klinike rajonale, 2 spitaleve të përgjithshme rajonale dhe 1 spitalit të përgjithshëm të qytetit. | | Të konstatohet - kohëzgjatja e parashikuar 7 vjet | 500.000.000 euro | | | | **95** |

# Индикативна листа на инвестициски проекти на ИРР

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 5 | Mbështetja e së drejtës së fëmijëve për zhvillim të shëndetshëm mendor përmes futjes së shërbimeve psikiatrike për fëmijët dhe adoleshentët | Struktura organizative aktuale dhe përgjegjësitë për shëndetin mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve (CAMH) janë të shpërndara dhe të fragmentuara dhe të bazuara në kapacitetet dhe lokacionet ekzistuese të ofruesve të shërbimeve. Qëllimi kryesor i strategjisë së propozuar për CAMH është vendosja e shërbimit nacional të qëndrueshëm, gjithëpërfshirës dhe efikas, sipas standardit të përbashkët në të gjithë Republikën.<br>Qëllimi i projektit CAMH për zhvillimin dhe zgjerimin e shërbimeve në të gjithë Maqedoninë e Veriut është modeli "hub and spoke". Sipas këtij modeli, duhet të themelohen 6 habë kryesorë të vendosur në qendrat më të mëdha të target-popullsisë së përkufizuar. | | Të konstatohet - kohëzgjatja e parashikuar 3 vjet | Rreth 8.5 milionë euro | | | | 95 |
| 6 | Modernizimi dhe “gjelbërimi” i Spitalit të Përgjithshëm 8 Shtatori | Qëllimi i projektit të propozuar janë aktivitetet për përfundimin dhe përmirësimin për nevojat e Spitalit të Përgjithshëm në Shkup. Ky ishte edhe konkluzioni për informimin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për rrjedhën dhe ecurinë e aktiviteteve të planifikuara për rinovimin e Spitalit të Përgjithshëm “8 Shtatori” Shkup. | E ARSYESHME | | rreth 20.000,00 për dizajnin vlerësimi i shpenzimeve për rikonstruksion: 20.000.000 euro | | | 2.500.000 euro-të siguruar nga Ministria e Shëndet | 87 |
| 7 | Drejt shëndetësisë moderne dhe qasjes së barabartë me ndërtimin e Spitalit të Përgjithshëm në Kërçovë | Qëllimi i projektit të propozuar janë aktivitetet për përfundimin dhe përmirësimin e ndërtimit për nevojat e Spitalit të Përgjithshëm në Kërçovë.<br>Objekti ekzistues është projektuar për nevojat e klinikës së ndërtuar në vitin 1985, me sipërfaqe të përgjithshme prej 6700 m2. | E ARSYESHME | Vitet 2021-2023 | Faza I - 3.410.000 euro me TVSH të miratuar nga MF-ja për punimet ndërtimore<br>Faza II - 4.900.000 euro pa TVSH | | | | 87 |
| 8 | Dekarbonizimi i sektorit shëndetësor | Rritja e karakteristikave energjetike të ndërtesave të institucioneve shëndetësore publike në vend, duke rezultuar në kursime që mund të riinvestohen në përmirësimin e mëtejshëm të karakteristikave energjetike të ndërtesave dhe lehtësimin e zbatimit të EPBD-së (Direktiva 2010/31/BE mbi karakteristikat energjetike të ndërtesave) | | Filloi në vitin 2023 - kohëzgjatja e parashikuar 5 vjet | Të konstatohet | | | | **81** |

# Индикативна листа на инвестициски проекти на ИРР

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 9 | Themelimi i Qendrës së parë Nacionale për trajtimin e fibrozës cistike tek të rriturit dhe fëmijët në Entin e Sëmundjeve të Frymëmarrjes - Kozle | Kërkesat dhe kriteret themelore të programit për përgatitjen e dokumentacionit të projektit përfshijnë:<br>1. Qendrën e Kujdesit Paliativ për Fëmijët<br>2. Qendrën e Fibrozës Cistike tek Fëmijët<br>Lëndë e këtij programi është revizioni i plotë i ambienteve për Qendrën funksionale të Kujdesit Paliativ dhe Qendrës së Fibrozës Cistike, me përgatitjen e dokumentacionit të plotë të projektit dhe projektit themelor që do të mundësojë rikonstruksionin e plotë të ambienteve të Institutit për Sëmundjet e Mushkërive tek Fëmijët - Kozle. (SHKUP) | E ARSYESHME | | Punimet ndërtimore:<br>1.500.000 euro<br><br>Mbikëqyrja e rinovimit:<br>300.000,00 euro | | | | 71 |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 10 | **Ndërtimi i 30 objekteve për arsimin fizik në shkollat fillore, prokurimi i pajisjeve dhe rikonstruksioni efikas energjetik i shkollave fillore dhe të mesme Faza III)** | Projekti është pjesë e programit më të madh të promovuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) për t'i përmirësuar arritjet e nxënësve në lëndët mësimore, për të forcuar gjendjen e tyre shëndetësore, për të rritur shkallën e regjistrimit dhe për të inkurajuar zhvillimin rural duke ofruar mjedis më të mirë për të mësuar, përfshirë edhe arsimin fizik.<br>Projekti i propozuar do të mundësojë promovimin e standardeve më të larta në ndërtimtari, zbatimin e sistemeve FV me burimet e rinovueshme të energjisë, arritjen e pavarësisë energjetike, dizajnet, planet e mirëmbajtjes dhe shpenzimet për të garantuar qëndrueshmërinë dhe cilësinë e investimeve.<br>Struktura aktuale e çekuilibruar e tarifave energjetike nuk stimulon konsumin racional të energjisë, rritja progresive e çmimeve të energjisë edhe me shkallë të ulët, e shpallur publikisht, do të ketë ndikim afatgjatë mbi inovacionet teknologjike, veçanërisht në sistemet diellore FV BRE që ofrojnë dekarbonizim dhe reduktimin e emisioneve të gazrave serrë<br>Ky projekt është në përputhje me Strategjinë Gjithëpërfshirëse për Arsimin 2018-2025 dhe Planin Strategjik 2024-2026 | E ARSYESHME | Vitet 2025-2030 | 53.750.000 euro<br>• Punimet ndërtimore të objekteve të arsimit fizik: 19.500.000 euro<br>• Mbikëqyrja e aktiviteteve: 500.000 euro<br>• Përgatitja e projektit për rikonstruksionin efikas energjetik të shkollave dhe sistemeve të paneleve fotovoltaike diellore: 1.500.000 euro<br>• Punimet ndërtimore për rikonstruksionin efikas energjetik të shkollave: 30.000.000 euro<br>• Mbikëqyrja e aktiviteteve: 750.000 euro<br>• Instalimi i sistemeve të paneleve fotovoltaike diellore: 1.500.000 euro | | | | |

# Индикативна листа на инвестициски проекти на ИРР

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 11 | **Rehabilitimi për efikasitetin energjetike të 4 shkollave shtetërore për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore - Qendrat Burimore** | Projekti është pjesë e programit më të madh të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH) që ka për qëllim të sigurojë kushte të barabarta dhe të përshtatshme për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore. Janë katër shkolla publike në vend që janë të fokusuara në arsimin e mesëm të këtyre nxënësve, gjë që është në përputhje me politikën e gjithëpërfshirjes në arsim.<br>Projekti i propozuar do të mundësojë promovimin e standardeve më të larta në ndërtimtari, zbatimin e sistemeve FV me burime të rinovueshme të energjisë, arritjen e pavarësisë energjetike, dizajnet, planet e mirëmbajtjes dhe shpenzimet për të garantuar qëndrueshmërinë dhe cilësinë e investimeve.<br>Struktura aktuale e çekuilibruar e tarifave energjetike nuk stimulon konsumin racional të energjisë, rritja progresive e çmimeve të energjisë edhe me shkallë të ulët, e shpallur publikisht, do të ketë ndikim afatgjatë mbi inovacionet teknologjike, veçanërisht në sistemet diellore FV BRE që ofrojnë dekarbonizim dhe reduktimin e emisioneve të gazrave serrë<br>Ky projekt është në përputhje me Strategjinë Gjithëpërfshirëse për Arsimin 2018-2025 dhe Planin Strategjik 2024-2026 | | Vitet 2025-2030 | • Rehabilitimi i katër shkollave shtetërore për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore - 6.000.000,00 euro<br>• Mbikëqyrja e aktiviteteve: 150.000 euro<br>• Përgatitja e projektit për rikonstruksionin efikas energjetik të shkollave dhe sistemeve të paneleve fotovoltaike diellore: 150.000 euro<br>• Instalimi i sistemeve të paneleve fotovoltaike diellore: 150.000 euro | | | | |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 12 | **Rehabilitimi për efikasitetin energjetik në 50 shkolla fillore ku nevojiten ndërtime me klasa të reja për kalimin në mësim në një ndërrim** | Qëllimi i projektit është zbatimi i programit gjithëpërfshirës të rehabilitimit të efikasitetit energjetik në shkollat fillore ku nevojiten ndërtime me klasa të reja për kalimin në mësim në një ndërrim.<br><br>Me rinovimin e objekteve dhe përmirësimin e cilësisë së arsimit fillor, Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) ka për qëllim futjen e mësimit me një ndërrim në shkollat dhe zbatimin e plotë të konceptit në arsimin fillor. Kjo e përmirëson të mësuarit e përgjithshëm duke ofruar mjedis arsimor më të qëndrueshëm dhe të fokusuar. Përveç kësaj, mësimi në një ndërrim ndihmon në uljen e ngarkesës logjistike mbi prindërit, duke u mundësuar që të mbështesin më mirë arsimimin e fëmijëve të tyre. | | Filloi në vitin 2024 – kohëzgjatja e parashikuar e zbatimit 2027 | 36.225.000 euro (pa TVSH) | 350.000 euro (pa TVSH) KIBP | 35.875.00 euro (pa TVSH) BEI, Banka Botërore ose tjetër | **99** |

# Индикативна листа на инвестициски проекти на ИРР

| Sektori energjetik | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Emri i projektit (përfshirja e sektorit) ENERGJETIKA** | **Përshkrimi i shkurtër i projektit (përfshirja e lokacionit)** | **Faza e projektit* (e arsyeshme) (detajet)** | **Kohëzgjatja e projektit (përgatitja + zbatimi** | **Shpenzimet totale të investimeve** | **Granti/Burimi** | **Huaja/Burimi** | **Bashkëfinancimi nacional** | **Vlerësimi i rëndësisë strategjike** |
| 1. | Forcimi i rrjetit të transmetimit në rajonin juglindor | Realizimi i projektit mundëson evakuimin e prodhimit të BRE-ve të planifikuara (elektranat hidro, me erë dhe fotovoltaike). | 1 | Viti 2026 | 43.381.000 euro | Korniza e Investimeve për Ballkanin Perëndimor (KIBP) 8.960.000 euro | BERZH 26.400.000 euro | ME PBE 8.021.000 euro | *1,48* |
| 2. | Forcimi i rrjetit të transmetimit në rajonin perëndimor përçuesit mbitokësorë 110 kV Gostivar - Kërçovë - Manastir | Analizat e sigurisë (kriteri N-1) tregojnë se në rajonin perëndimor me hidrologji të lartë (me angazhim maksimal të HEC Kozjak dhe HEC Shën Petkë dhe prodhim nominal të TEC Osllomej) për raste të paparashikuara, pas integrimit të elektranave fotovoltaike në këtë pjesë të rrjetit, paraqiten ngarkesat kritike në këta largpërçues 110 kV: TS Gostivar - TEC Osllomej - TS Kërçovë - TS Sopotnicë - TS Manastir 1, si dhe në largpërçuesin HEC Kozjak - HEC Shën Petkë - TS Shkup. Problemi i mbingarkesës në rajonin perëndimor është planifikuar të zgjidhet me rikonstruksionin / rivitalizimin e tërë shtrirjes 110 kV Gostivar - Osllomej - Kërçovë - Sopotnicë - Manastir 1, duke përdorur përçues me fuqi më të madhe transmetuese dhe ulje të vogël (AAAC). | 1 | Viti 2026 | 8.275.000 euro | | | MEPSO 8.275.000 euro | 1,03 |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 3. | Teknologjia e rrjetit të mençur për menaxhimin e sistemit elektroenergjetik, trafostacioneve digjitale dhe të gjelbra | Me qëllim të futjes së komponentëve modernë të mençur në rrjetin e transmetimit, MEPSO do të zbatojë pako projektesh që do të mundësojnë ndjekje dhe menaxhim më të mirë të rrjetit, si dhe shpërndarje uniforme të flukseve të energjisë elektrike dhe menaxhim të mjeteve. Gjithashtu, MEPSO do t'i digjitalizojë edhe trafostacionet Manastir 2 dhe Sopotnicë. | 1 | Viti 2026 | 14.110.000 euro | | | | 0,74 |
| 4. | Forcimi i rrjetit të transmetimit në rajonin verilindor | Për shkak të integrimit të kapacitetit të madh të burimeve të rinovueshme të energjisë nga energjia e erës dhe diellore, rritja e ngarkesës në rajonin verilindor në planin afatmesëm dhe afatgjatë, si dhe për shkak të prishjes së sigurisë së punës së sistemit të kriterit N-1, është e domosdoshme të ndërtohet TS Kumanovë e re 400/110 kV, bashkë me shpalosjen e përçuesve 110 kV dhe rishpërndarjen e ngarkesave ndërmjet 110 kV TS Kumanovë 1, 110 kV TS Kumanovë 2 dhe 110 kV të reja TS Kumanovë 3. | 3 | Viti 2032 | 17.220.000 euro | | | | 1,03 |
| 5. | Ndërtimi i centraleve të reja prej 400 kV për integrim të lehtë dhe qasje në rrjet të BRE-ve | Realizimi i projektit mundëson evakuimin e prodhimit të BRE-ve të planifikuara (elektranat me erë dhe fotovoltaike). | 3 | Viti 2026 | 50.000.000 euro | | | | 1,42 |
| 6. | Elektrana e gazit me ciklin e kombinuar (CCGT) Negotinë | Ndërtimi i elektranës së re të gazit me cikël të kombinuar (CCGT) prej 250-500 MW në Negotinë me hidrogjen / gaz natyror. | 3 | Vitet 2024-2030 | 300 – 600.000.000 euro | | | | 1,51 |
| 7. | Rrjetet diellore për ngrohjen qendrore në Manastir | Faza tjetër e projektit të Ngrohjes Qendrore me Diell të Manastirit (Manastir SDH) do të rrisë pjesën e burimeve të rinovueshme të energjisë në përzierjen energjetike të vendit, me fokus në sektorin e ngrohjes, me kapacitet prej 20-30 MWt. | 3 | Vitet 2024-2030 | 40-50.000.000 euro | | | | 0,87 |

# Индикативна листа на инвестициски проекти на ИРР

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 8. | Elektrana e kombinuar e gazit në Manastir | Ndërtimi i elektranës së re të gazit me cikël të kombinuar (CCGT) prej 250 MW në Manastir me hidrogjen / gaz natyror. | 3 | Vitet 2024-2030 | 300-400.000.000 euro | | | | 0,93 |
| 9. | SCADA, Softueri për planifikimin e prodhimit dhe tregtisë me energjinë elektrike | Zëvendësimi i sistemit ekzistues për planifikimin dhe menaxhimin e njësive të prodhimit.<br>Optimizimi i prodhimit të energjisë elektrike do të mundësohet duke angazhuar njësitë e prodhimit që janë ekonomikisht më fitimprurëse për përdorim në periudhën e caktuar të planifikimit. | 3 | Vitet 2023-2025 | 6.000.000 euro | | | | 0,933 |
| 10. | Deponimi i baterive | Investimi në kapacitetet balancuese – Sistemet e deponimit të baterive, përveç impianteve fotovoltaike të mëdha të ardhshme diellore në Manastir, Shtip dhe Kërçovë. Kapaciteti fillestar i baterive deri në 300 MWh do të jetë i mjaftueshëm për fazën e parë, për impiantet fotovoltaike diellore deri në 1880 MW, të planifikuara në zonën e Komunës së Shtipit; zonën e TEC Osllomej (Komuna e Kërçovës), dhe zonën e TEC Manastir | 3 | Vitet 2024-2030 | 100.000.000 euro | | | | 0,98 |
| 11. | Përmirësimi dhe mbindërtimi i sistemit të shpërndarjes së energjisë termike në Shkup | Qëllimi i Projektit është krijimi i sistemit më të qëndrueshëm, më ekonomik dhe më efikas të ngrohjes qendrore për Shkupin. Duke integruar burimet e rinovueshme të energjisë, duke optimizuar burimet termike nga impiantet e bashkëgjenerimit (CHP) dhe mbetjet industriale, si dhe duke përmirësuar në mënyrë strategjike rrjetin, qëllimi është përmirësimi i besueshmërisë së sistemit, reduktimi i ndikimit mbi mjedisin jetësor dhe reduktimi potencial i shpenzimeve për konsumatorët. | 3 | Vitet 2025-2032 | 93.200.000 euro | | | | 0,93 |
| 12. | Fondi i Efikasitetit Energjetik | Fondi i Efikasitetit Energjetik do të themelohet në kuadër të Bankës për Zhvillim të Maqedonisë së Veriut në vitin 2024, si mekanizëm afatgjatë për financimin e projekteve të efikasitetit energjetik të sektorit publik dhe privat dhe të amvisërive në të ardhmen. Kapitali fillestar sigurohet nëpërmjet huas nga BB-ja. | | Vitet 2024-2027 | 40.400.000 euro | 2.100.000 euro Korniza e Investimeve për Ballkanin Perëndimor (KIBP) | 5.000.000 euro BB | 10.000.000 euro Fletobligacioni i gjelbër | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 13. | Plani për rinovimin e ndërtesave të pushtetit qendror | Qëllimi i përgjithshëm i Planit të Rinovimit është të arrijë përmirësime në efikasitetin energjetik në sektorin ndërtimor dhe të ndihmojë në përmbushjen e qëllimeve strategjike siç theksohet në dokumentet strategjike nacionale. | 2 | Vitet 2024-2027 | 9.400.000 euro | | | 620.000 euro | |
| 14. | Interkonektori i gazit Republika e Maqedonisë së Veriut - Serbia | Diversifikimi i gazit natyror, përkatësisht furnizimi me gaz natyror nga burime të tjera në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe mundësia e tranzitit të gazit natyror nga Greqia përmes Maqedonisë së Veriut deri në Serbi.<br>Është përgatitur projekti infrastrukturor për segmentin rrugor Kleçovcë - Sopot (kufiri me Serbinë) për interkonektorin e gazit Republika e Maqedonisë së Veriut - Serbia.<br>Përshkrimi i përgjithshëm është bashkangjitur si Rezyme Ekzekutive e Studimit të Fizibilitetit për sistemin e gazsjellësit në Republikën e Maqedonisë së Veriut me projektin ideor. | E ARSYESHME | Vitet 2025-2026 | 23.950.000 euro | | | * nuk janë përkufizuar burimet e mjeteve | 2,96 |